




# TRANSPARENCA DHE AKSESI NË INFORMACION PUBLIK



**Udhëzues**



# **TRANSPARENCA DHE AKSESI NË INFORMACION PUBLIK**

## Udhëzues

Autore: Armela Xhaho, PhD

@ Peace Volunteering Network  
Tiranë, 2024

Pikëpamjet dhe informacionet e dhëna në këtë dokument janë vetëm të autorëve dhe nuk shprehi domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e donatorit

Ky udhëzues u hartua në kuadër të Projektit “Promovimi i monitorimit Qytetar dhe përfshirjes së të rinjve në qeverisjen lokale ” që zbatohet nga PVN me mbështetjen financiare të National Endowment for Democracy



## Përmbajtja

I. Hyrje.....	4
Objektivat e modulit të trajnimit: .....	6
Si e ndihmon transparenca mirëqeverisjen?.....	6
Akresi në Informacion dhe Demokracia:.....	7
Çfarë është e drejta për informim?.....	7
Pse është e rëndësishme e drejta për informim në nivel vendor?.....	8
II.Kuadri ligjor që rregullon të drejtën për informim .....	15
III.Informimi publik.....	15
Informimi me kërkesë .....	17
Kur kufizohet e drejta për informim? .....	19
IV.Programi i Transparencës .....	23
Strukturat për Informacion dhe Monitorim mbi të drejtën për informim .....	26
V.Instrumenti i Vlerësimit së Transparencës Proaktive .....	28
Vlerësimi proaktiv .....	29
Programi i Transparencës .....	29
Vlerësimi i Transparencës reaktive përmes kërkesave për informim.....	29
Pikëzimi dhe transparenca e bashkive .....	30
Aneks 1.Vlerësimi i programit te transparencës .....	31
Aneks2. Ushtrime praktike.....	39

## I. Hyrje

E drejta për informim nuk përbën vetëm një nga të drejtat themelore të njeriut, por është parakusht për qeverisje të hapur që garanton transparencë dhe llogaridhënie. Vetëm kohët e fundit e drejta për informim është njohur dhe afirmuar gjerësisht, por rrënjët dhe koncepti i saj datojnë që në shekullin e 18-të. Kjo e drejtë është garantuar për herë të parë në legjislacionin suedez, në Ligjin e Lirisë së Shtypit, të Mbretërisë Suedeze. Në këtë kontekst historik, vendet nordike njihen sot ndërkombëtarisht si pararendësit në çështjet e transparencës dhe të aksesit në informacion. E drejta për tu informuar në Shqipëri garantohet ekskluzivisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Ligji Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

E drejta për informim përcakton se kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore. E drejta e informimit u krijon akses qytetarëve në dokumente zyrtarë dhe ndihmon personat, interesat e të cilëve preken nga vendimmarrje të mundshme administrative, duke u njohur me vendimmarrjet por edhe me procedurën e ankimit. Nga ana tjetër, institucionet publike kanë detyrimin të jenë pro-aktiv në informimin e qytetarëve dhe të aktorëve të interesit.

Ky modul trajnimi

Ndërmarrja e nismave të përbashkëta, për rritjen e ndërgjegjësimit të aktorëve publik dhe civil në lidhje me transparencën, është e rëndësishme për të siguruar një vetëdije më të lartë qytetare në ushtrimin e një nga të drejtave themelore të njeriut, siç është ajo e së drejtës për informim. Në mënyrë që të adresojmë këto sfida, është prioritarë hartimi i mekanizmave monitorues të transparencës dhe ngritja e kapaciteteve të shoqërisë civile mbi zbatimin e tyre. Nisma të tilla sigurojnë që procesi i informimit dhe konsultimit të jetë sa më transparent, efektiv dhe gjithëpërfshirës.

Padyshim që pjesëmarrja shoqërisë civile dhe kryesisht OSHC-ve rinore është prioritarë për sa i përket nxitjes së aktivizimit dhe ndërgjegjësimit të grupeve të interesit për njohjen dhe ushtrimin e të drejtës për informim, njoftimin dhe konsultimin publik në qeverisjen vendore. Një nga objektivat kryesor të kësaj nisme është të kontribuojë në parandalimin e korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore në Shqipëri, përmes përmirësimit të transparencës dhe llogaridhënies vendore. Në këtë aspekt, projekti “Organizatave Rinore, Media dhe të Rinjtë për Monitorimin e Transparencës dhe Llogaridhënies në Pushtetin Lokal” synon të forcojë kapacitetet e OSHC-ve rinore dhe aktorëve të tjerë civilë për të monitoruar në mënyrë objektive zbatueshmërinë e detyrimeve që rrjedhin nga ligji Nr.119/2014, “Për të Drejtën e Informimit” në lidhje me transparencën proaktive dhe reaktive të institucioneve në nivel vendore, duke u fokusuar në nismat, projektet dhe OSHC-të. Më konkretisht, përmes kësaj ndërhyrje, PVN do të asistoj teknikisht duke rritur kapacitetet e organizatave të Shoqërisë Civile, me qëllim që këto OSHC të advokojnë në mënyrë efektive për të nxitur transparencën dhe përgjegjshmërinë në vendimmarrjen vendore.

Për këtë qëllim, ky manual ka për qëllim t'u vijë në ndihmë OSHC-ve vendore, gazetarëve, aktivistëve të shoqërisë civile, si dhe çdo qytetari të thjeshtë që ka nevojë për informacion nga autoritetet publike. Me qëllim që manuali të jetë sa më i thjeshtë dhe i kuptueshëm për qytetarët, ai është konceptuar në një formatin më praktik, cka lehtëson që OSHC-të të informohen në lidhje me ushtrimin e të drejtës së informimit.

Në përpjekje të përbashkëta për të promovuar një kulturë transformuese në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies vendore, PVN ka hartuar një instrumentin vlerësues të transparencës proaktive dhe reaktive në nivel vendor.

Target grupi kryesor i përdoruesve të këtij udhëzuesi përfshin përfaqësuesit e OSHC-ve dhe mediave vendore. Më tej udhëzuesi shërben si një instrument bazë për të gjithë aktorët e shoqërisë civile qytetarë për realizimin e procesit të monitorimit të transparencës dhe llogaridhënies në 61 bashkitë e vendit.

### ■ Objektivat e modulit të trajnimit:

- Të pajisë trajnerët me njohuri dhe aftësi të duhura mbi zbatimin e të drejtës për informim në nivelin e vetëqeverisjes vendore;
- T'ju ofrojë trajnerëve udhëzime konkrete mbi modalitetet e qasjes në informacion publik, procedurat për tu informuar e ankimuar;
- T'ju mundësojë pjesëmarrësve një qasje praktike për të analizuar dhe reflektuar mbi rëndësinë e transparencës në ndërveprimin e qytetarëve me institucionet qeverisëse, rolin e rëndësishëm monitorues të OSHC-ve dhe aktorëve të tjerë civil në llogaridhënien, mirëqeverisjen dhe luftën kundër korrupsionit;
- Të rrisë njohuritë dhe aftësitë e trajnerëve mbi zbatimin dhe monitorimin të kësaj të drejte nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të vlerësimit dhe ushtrimeve praktike



### Si ndihmon transparenca mirëqeverisjen?

Transparenca dhe llogaridhënia janë dy elemente thelbësore që ndikojnë thellësisht në mënyrën se si qytetarët shohin dhe besojnë në institucionet vendore. Këto dy koncepte përcaktojnë mënyrën se si bashkitë funksionojnë dhe shërbejnë komunitetin.

Bashkitë, si niveli i qeverisjes më pranë qytetarëve kanë një rol kyç në përmirësimin e pjesëmarrjes së qytetarëve, ndërveprimin me ta dhe sigurimin e shërbimeve publike të cilat plotësojnë nevojat vendore.

Të dy parimet janë të lidhura me njëra-tjetrën, ku transparenca e autoriteteve të qeverisjes vendore përfaqëson një hap të parë drejt llogaridhënies së të zgjedhurve vendorë dhe ndërtimit të besimit me publikun.

- **Lufton Korrupsionin:** Në një mjedis transparent, veprimet dhe vendimet e institucioneve janë më transparente ndaj publikut. Kjo zvogëlon mundësinë e veprimeve të paligjshme dhe korrupsionit, pasi qytetarët dhe organizatat mund të monitorojnë dhe raportojnë raste të dyshimta.
- **Rrit Besimin e Publikut:** Kur institucionet janë transparente, besimi publik rritet. Qytetarët kanë më shumë besim në qeverinë dhe institucionet e tyre, duke ndikuar në stabilitetin dhe zhvillimin e shoqërisë.

## Aksesi në Informacion dhe Demokracia:

**Pjesëmarrje Aktive e të rinjve në proceset demokratike :** Aksesi në informacion lejon të rinjtë të jenë pjesëmarrës aktiv në jetën demokratike. Ata mund të marrin vendime të informuara dhe të ndikojnë në proceset vendimmarrëse.

**Mbikëqyrja e Institucioneve:** Aksesi në informacion ndihmon qytetarët të monitorojnë dhe të kontrollojnë veprimtarinë e institucioneve. Ky kontroll është një komponent kyç për funksionimin e një demokracie të shëndetshme.

**Forcimi i Llogaridhënies:** Aksesi në informacion bën që institucionet të jenë më përgjegjshme ndaj qytetarëve. Ata janë të detyruar të japin llogari para qytetarëve për veprimet dhe politikat e tyre.

Përdorimi i këtyre koncepteve është i rëndësishëm për krijimin e një mjedisi ku INSTITUCIONET dhe QYTETARËT punojnë së bashku për të ndërtuar dhe PROMOVUAR një shoqëri të drejtë dhe transparente.

## Çfarë është e drejta për informim?

- **Qëllimi i së drejtës për informim:**
- *Garantimi i njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë;*
- *Garantimi i formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë;*
- *Nxitja e integritetit, transparencës dhe përgjegjshmërisë të autoriteteve publike.*
- **Subjektet që kanë të drejtë të informohen:**
- *Si çdo e drejtë e njeriut, e drejta për informimin u përket të gjithëve. Kjo përfshin personat fizikë (shtetas shqiptarë, të huaj, si dhe pa shtetësi), personat juridikë, organizata jo-qeveritare (OJQ) dhe përfaqësuesit ligjore të personave fizikë ose juridikë. Business operators and entrepreneurs*

◦ **Përkufizimi i "informacionit publik":**

- "Informacion publik" është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik. Kjo do të thotë se autoriteti publik është i detyruar të japë informacion dhe dokumentacion të prodhuar nga vetë autoriteti, nga autoritete të tjera publike, ose nga subjekte private, por që disponohen nga autoriteti publik.
- 

**Pse është e rëndësishme e drejta për informim në nivel vendor?!**

Organet e njësisve të qeverisjes vendore si autoritete publike mbartin detyrimin e garantimit të së drejtës për informim si detyrim kushtetues dhe ligjor për të siguruar transparencën e veprimitarisë së tyre.

E drejta e aksesit në informacion publik përmirëson transparencën dhe llogaridhënien në nivelin e vetëqeverisjes vendore.

Transparenca dhe llogaridhënia janë dy parime të rëndësishme të qeverisjes së mirë vendore.

**TRANSPARENCA** – Transparenca në kontekstin e shërbimeve publike përfshin publikimin e informacionit procedural dhe përmbajtësor në një mënyrë që të jetë i lehtësisht i aksesueshëm dhe i kuptueshëm për individët dhe grupet e shoqërisë. Transparenca është një nga instrumentet kryesore të mirëqeverisjes dhe luftës kundër korrupsionit.

**Disa elemente thelbësore të transparencës në shërbimet publike janë:**

- Publikimi i Informacionit Procedural: Përshkrimi i hollësishëm i procedurave administrative dhe proceseve që lidhen me shërbimet publike. Kjo përfshin udhëzime, formularë, dhe informacione të tjera të nevojshme për të kuptuar dhe përdorur shërbimet.
- Publikimi i Informacionit Përmbajtësor: Paraqitja e informacionit mbi cilësinë dhe karakteristikat e shërbimeve publike. Ky aspekt përfshin të dhëna të tilla si kriteret për përfshirjen në shërbim, koha e pritjes, dhe cilësimet e mundshme.
- Aksesueshmëria e Informacionit: Sigurimi që informacioni është i lehtësisht i aksesueshëm nga qytetarët. Kjo mund të bëhet përmes publikimit online të dokumenteve, faqeve të internetit, ose metoda të tjera të komunikimit të hapur.





Disa elemente thelbësore të transparencës në shërbimet publike janë:

- **Kuptueshmëria e Informacionit:** Përdorimi i gjuhës dhe formatit të kuptueshëm për audiencën e synuar. Për shembull, informacioni duhet të jetë i shkruar në një gjuhë të thjeshtë dhe të qartë për të siguruar që të gjithë mund ta kuptojnë.
- **Respektimi i Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë:** Transparenca duhet të respektojë dhe të përputhet me rregulloret dhe ligjet që mbrojnë të dhënat personale dhe privatësinë e individëve.
- Në përgjithësi, transparenca ndihmon në rritjen e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve publike, duke i dhënë tyre mundësinë të monitorojnë dhe të vlerësojnë efikasitetin dhe drejtësinë e shërbimeve publike.
- **Publikimi i informacionit procedural dhe përmbajtësor i shërbimeve publike** në mënyrë të tillë që të jetë i aksesueshëm dhe gjerësisht i kuptueshëm nga individët dhe grupe të caktuara të shoqërisë duke respektuar kufizimet për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë;

Në kontekstin e administratës publike dhe vendimmarrjes, përfshin përgjegjshmërinë e zyrtarëve publikë kundrejt veprimeve dhe vendimeve të tyre, duke siguruar se ato janë në përputhje me procedurat ligjore dhe standardet e caktuara. Ky koncept shpesh njihet edhe si "kontrollo dhe balanco" në kontekstin institucional.

Për të pasuar këtë parim, disa elemente thelbësore janë përfshirë në llogaridhënie:

- **Respektimi i Procedurave Ligjore:** Zyrtarët publik duhet të ndjekin dhe të respektojnë procedurat dhe rregulloret ligjore në procesin e vendimmarrjes. Kjo përfshin zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve aktuale dhe garantimin e përputhshmërisë së veprimeve me to.
- **Kontrollo dhe Balanco:** Institucionet duhet të kenë mekanizma të brendshëm dhe të jashtëm për të kontrolluar dhe vlerësuar vendimet dhe veprimet e zyrtarëve. Kjo mund të përfshijë një sistem të pavarur të mbikëqyrjes, rishikimin e brendshëm, ose të tjera forma të mbikëqyrjes që sigurojnë llogaridhënie.
- **Përgjegjshmëria Individuale:** Zgjedhja dhe zbatimi i vendimeve duhet të shoqërohet me përgjegjshmëri individuale. Zyrtarët publik duhet të jenë të vetëdijshëm për pasojat e veprimeve të tyre dhe të jenë të gatshëm të përgjigjen për to.
- **Transparenca dhe Informacioni Publik:** Informacioni mbi vendimet dhe veprimet duhet të jetë i hapur dhe i aksesueshëm për publikun. Kjo rrit llogaridhënien duke i mundësuar publikut të monitorojë dhe të vlerësojë veprimtarinë e zyrtarëve.
- **Parimi i llogaridhënies** ka për qëllim të sigurojë që zyrtarët publik të jenë të përgjegjshëm, duke parandaluar abuzimet dhe garantuar që vendimet e tyre të jenë në përputhje me vlerat dhe ligjet e shoqërisë. Kjo gjithashtu ndihmon në rritjen e besimit të publikut në institucionet dhe zyrtarët publik.



## Pse është i rëndësishëm angazhimi i të rinjve në monitorimin e transparencës vendore?

Transparenca është e rëndësishme sepse u mundëson të rinjve të monitorojnë dhe kontrollojnë punën e institucioneve dhe nëpunësve publikë. Aksesit në informacion është një instrument për të parandaluar punën e dobët, shkeljet, abuzimet me pushtetin dhe korrupsionin.

Si ndihmon transparenca dhe aksesit në informacion?

- 1 Të rinjtë janë më të vetëdijshëm për të kërkuar të drejtat e tyre
- 2 Mundëson që të rinjtë të kenë një rol mbikëqyrës ndaj institucioneve vendore. Të rinjtë kanë mundësi të monitorojnë dhe vlerësojnë cilësinë e shërbimeve, me qëllim përmirësimin e këtyre shërbimeve
- 3 Ndhmon në përmirësimin e politikave publike vendore
- 4 Lehtëson marrjen e vendimeve dhe politikave publike të informuara, të cilat janë më efikase, plotësojnë nevojat reale dhe reflektojnë vlerat e komunitetit dhe të rinjve
- 5 Ndhmon në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke fuqizuar të rinjtë për të luftuar padrejtësitë dhe
- 6 Angazhimi i të rinjve rrit shanset që komuniteti të pranojë politikën dhe vendimet e ndërmarra nga qeveria
- 7 Ndhmon në përmirësimin e politikave publike vendore  
Rrit interesin dhe angazhimin e të rinjve në proceset vendimmarrëse duke kontribuar në nxitjen e qytetarisë aktive
- 8 Rrit besimin e të rinjve në qeverisjen lokale
- 9 Promovon transparencën dhe përgjegjshmërinë publike
- 10 Ndhmon në forcimin e demokracisë vendore dhe në minimizimin e praktikave korruptive

PJESËMARRJA E TË RINJVE NË QEVERISJE lidhet ngushtë me hapjen dhe transparencën e institucioneve publike. Njëkohësisht, niveli i pjesëmarrjes së të rinjve në qeverinë lokale shpesh përdoret si indikator për të vlerësuar nivelin e demokracisë vendore. Në këtë këndvështrim, institucionet vendore duhet jo vetëm të ftojnë të rinjtë për të marrë pjesë, por duhet ti sigurojnë atyre hapësira të mjaftueshme për të ndarë ide, për tu ankuar, diskutuar me ta çështjet që kanë të bëjnë me përmirësimin e jetës dhe mirëqenies së komuniteteve lokale. Institucionet vendore duhet të sigurojnë mekanizma mundësues për një dialog të vazhdueshëm, duke i përfshirë të rinjtë në mënyrë aktive në politikëbërje dhe vendimmarrje.

Angazhimi i të rinjve në monitorimin e transparencës vendore është i rëndësishëm për disa arsye të përcaktuara:

**Perspektiva inovatore:** Të rinjtë shpesh kanë një perspektivë më të re mbi çështjet aktuale. Përfshirja e tyre në monitorimin e transparencës mund të sjellë ide më inovative duke kontribuar në zgjidhjen e problemeve dhe në përmirësimin e proceseve vendore.

**Forcimi i Demokracisë Lokale:** Angazhimi i të rinjve në monitorimin e transparencës rrit pjesëmarrjen e tyre në jetën demokratike lokale. Përvoja e tyre në këtë fushë mund t'i ndihmojë ata të kuptojnë proceset demokratike dhe të ndihmojnë në forcimin e demokracisë lokale.

**Përdorimi i Teknologjisë:** Të rinjtë janë shpesh më të përfshirë në teknologji dhe mediat sociale. Përdorimi i tyre i këtyre mjeteve mund të intensifikojë shpërndarjen e informacionit dhe të nxisë transparencën në mënyra inovative.

**Forcimi i Besimit Publik:** Pjesëmarrja e të rinjve në monitorimin e transparencës mund të ndihmojë në ndërtimin e besimit publik ndaj institucioneve lokale. Kur qytetarët shohin se një grup i përbërë kryesisht nga të rinj po monitoron transparencën dhe përdor teknologji për të sjellë ndryshime, ata mund të kenë më shumë besim në proceset vendore.

**Angazhim qytetar:** Përvoja e të rinjve në monitorimin e transparencës mund t'i përgatisë ata për angazhimin qytetar në të ardhmen. Kjo mund të ndikojë në zhvillimin e liderëve të ardhshëm dhe aktivistëve që janë të përfshirë në çështje sociale dhe politike.

**Promovimi i Ndërgjegjësimit:** Përmes angazhimit të të rinjve në monitorimin e transparencës, mund të promovohet ndërgjegjësimi social. Të rinjtë mësojnë se përmes veprimeve të tyre, ata mund të ndikojnë në përmirësimin e shoqërisë dhe në luftën kundër korrupsionit.

## II. Kuadri ligjor që rregullon të drejtën për informim

Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe njofimit të informacionit dhe ideve me çfarëdo mjeti qofë, pa marrë parasysh kufjtë

DEKLARATA UNIVERSALE E TË DREJTAVE TË NJERIUT, Neni 19

KUSHTETUTA e Republikës së Shqipërisë, Kreu II Liritë dhe Të Drejtat

### Liritë dhe të Drejtat Vetjake

1. E drejta e informimit është e garantuar.
2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.
3. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.

### E drejta e informimit

1. Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.
2. Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.
3. Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.
4. Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji.

LIGJI Nr. 119/2014  
"Për të drejtën e informimit", i ndryshuar

### Transparenca e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes Vendore

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre.
2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afshohet në vendet e caktuara nga njësia për njofimet publike.
3. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatoren e transparencës dhe të miratojë programin e transparencës, duke siguruar akses nga të gjithë, veçanërisht nga shtresat më të varfra të komunitetit, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për të drejtën e informimit.

LIGJI Nr. 139/2015  
"Për Vetëqeverisjen Vendore"

### Informimi me kërkesë

E drejta qytetarëve të kërkojnë informacion pa shpjeguar motivet e kërkesës dhe detyrimi i institucioneve publike për të përmbushur këtë të drejtë duke respektuar kufizimet e të drejtës së

Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet :

- Dorazi- Duke ruajtur numrin e protokollit
- Nëpërmjet shërbimit postar – Ruaj kuponin postar
- Nëpërmjet e-mailit – Ruaj e-mailin e dërguar me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij.



### Si mund të bëjmë një kërkesë për informacion?

1.Kliko faqen zyrtare të bashkisë dhe verifiko nëse informacioni që kërkon nuk është i shpallur në faqen e internetit apo në Programin e Transparencës.

2. Nëse informacioni nuk është në programin e transparencës, gjeni të dhënat e koordinorit për të drejtën e Informimit në faqen e internetit të institucioni.

### Si mund të bëjmë një kërkesë për informacion?

3.Shkarkoni formularin e kërkesës për informacion në faqen e internetit të institucionit dhe i bëni një kërkesë me shkrim koordinorit për të drejtën e informimit.

### Informimi pa kërkesë

- Detyrimi i institucioneve publike për të publikuar një gamë të madhe informacionesh publike që prodhohen dhe disponohen nga ato. Informimi pa kërkesë realizohet nëpërmjet Programit të transparencës (PT) i cili përkufizohet si tërësia e informacionit dhe mënyrat e bërjes publike të tij nga autoriteti publik.
- PT përfaqëson instrumentin kryesor të transparencës në nivel vendor, që çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar ligjërisht ta zbatojë.
- Bashkia, si njësi bazë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet Programit të Transparencës (PT) synon t'u garantojë qytetarëve të vet të drejtën e lirisë së shprehjes për çështjet vendore.
- PT i bënë bashkitë proaktive në lidhje me ofrimin e informacionit publik.

### Ku gjendet PT?

*On-line:* PT publikohet në faqen zyrtare të internetit të bashkisë, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës”.

*I printuar:* PT vendoset në vendet e caktuara për njoftimet publike të bashkisë, njësive administrative dhe njësive të varësisë.



Informimi me kërkesë : **Formati i kërkesës për informacion: shembull ilustrues**

**KËRKESË PËR INFORMACION**

<b>Emër Mbiemër:</b> Z./Znj. _____	<b>Adresa postare:</b> _____ <b>Adresa elektronike:</b> _____ <b>Nr. Tel:</b> _____	<b>Data:</b> __/__/201__ <b>Nënshkrimi:</b> _____
---------------------------------------	---	--

*(dërgimi i kërkesës elektronikisht kërkon emër, mbiemër)*

Përshkrim i detajuar i informacionit të kërkuar

Të tjera të dhëna

<b>Forma që kërkohet informacioni / dokumentacioni:</b> _____
---

Vetëm për përdorim zyrtar		
<b>Data e marrjes:</b> __/__/201__	<b>Numri rendor i kërkesës:</b> _____	<b>Komente:</b> _____

Informacioni në këtë format do të përpunohet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

- ❖ Adresa dhe kontaktet mund të gjenden nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik pyetshetin.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.
- ❖ Drejtoni kërkesën tuaj, Koordinatorit për të drejtën e informimit, të institucionit që mban informacionin e kërkuar. Kontaktet e tij, janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit dhe në portalin pyetshetin.al.
- ❖ Kur ju mendoni se ju kanë mohuar ndonjë prej të drejtave tuaja në bazë ligjit, keni të drejtë të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

## Cilat janë afatet e kthimit të përgjigjeve mbi kërkesën për informim?

Afatet e kthimit të përgjigjeve mbi kërkesën për informim, sipas Ligjit, janë për sa vijon:

- jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të kërkesës, autoriteti publik duhet ta trajtojë, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur;
- jo më vonë se 15 ditë pune nga dita e mbërritjes së kërkesës në autoritetin e parë, kur autoriteti publik që merr kërkesën për informim ia dërgon atë një autoriteti tjetër;
- të dyja këto afate mund të zgjaten me jo më shumë se 5 ditë pune, për një nga shkaqet e mëposhtme:

a) nevoja për të kërkuar dhe shqyrtuar dokumente të shumta e voluminoze;

b) nevoja për t'i shtrirë kërkimet në zyra dhe mjedise që janë fizikisht të ndara nga zyra qendrore e autoritetit;

c) nevoja për t'u konsultuar me autoritete të tjera publike përpara marrjes së një vendimi për plotësimin ose jo të kërkesës.

Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës për informim nga nëpunësi civil brenda afateve të

## Kur kufizohet e drejta për informim?



Rastet e kufizimit të kërkesës për informacion:

Ligji për të Drejtën e Informimit parashikon se e drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm:



a) Të Drejta për Një Jetë Private: Kufizimet janë të justifikuara kur dhënia e informacionit dëmton të drejtat e jetës private të individëve. Për shembull, informacioni personal i një personi mund të mbrohet për të ruajtur privatësinë e tyre.

b) Sekreti Tregtar: Kur dhënia e informacionit mund të dëmtojë interesat e biznesit, përfshirë sekretin tregtar, ligji mund të kufizojë të drejtën e informimit për të mbrojtur këto interesa.

c) Të Drejta e Autorit: Kufizimet janë të nevojshme për të mbrojtur të drejtat e autorit mbi krijimtarinë e tyre. Ky aspekt lidhet me mbrojtjen e pronës intelektuale dhe mund të përfshijë rregulla për shfrytëzimin e kësaj informacioni nga të tjerët.

ç) Patentat: Kufizimet janë të nevojshme për të mbrojtur të drejtat e pronës industriale, përfshirë patentat. Informacioni i lidhur me inovacionet dhe teknologjitë e reja mund të mbrohet për të inkurajuar zhvillimin dhe investimet në këto fusha.

Parimi i "proporcionalitetit" nënkupton se kufizimet duhet të jenë të përmbajtura dhe të kërkojnë vetëm në masën kur është e domosdoshme për të mbrojtur këto interesa. Ligji për të drejtën e informimit përcakton një balancë midis nevojave të qytetarëve për informacion dhe mbrojtjes së interesave ligjore të tjera.

Po kështu e drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm:

- a) sigurinë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni për informacionin e klasifikuar;
- b) parandalimin, hetimin dhe ndjekjen e veprave penale;
- c) mbarëvajtjen e hetimit administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor;
- ç) mbarëvajtjen e procedurave të inspektimit dhe auditimit të autoriteteve publike;
- d) formulimin e politikave monetare dhe fiskale të shtetit;
- dh) barazinë e palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor;
- e) këshillimin dhe diskutimin paraprak brenda ose midis autoriteteve publike për zhvillimin e politikave publike;
- ë) mbarëvajtjen e marrëdhënieve ndërkombëtare ose ndërqeveritare.

Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilit argument ligjor është bërë refuzimi.

Në qoftë se kërkesa për informim nuk e përcakton formatin në të cilin kërkohet informacioni, ai jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik. Autoriteti publik bën të mundur që informacioni, i cili i është dhënë të paktën një herë një kërkuar, të bëhet i disponueshëm në mënyrën më praktike të mundshme për të gjithë personat e tjerë që mund ta kërkojnë në të ardhmen.

### Çfarë mund të bëjmë nëse na refuzohet kërkesa për informacion?

Çdo person, kur vlerëson se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ligji 119/2014 “Për të drejtën e informimit” ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

### Ankimi bëhet në rastet kur bashkia:

- Refuzon dhënien e informacionit/ nuk përgjigjet
- Kthen përgjigje pa vënë në dispozicion dokumentin e kërkuar
- Kthen përgjigje të paplotë

Si të ankoheni tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale?

Shkarkoni formatin e ankesës në faqen e internetit të institucionit, bëni një ankesë me shkrim dhe dërgojeni pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me: a) e-mail; b) dorazi c) postë.

Ankimimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve nga ;

- 1)Data kur ankuesi ka marrë njoftimin dhe refuzimin e informacionit
- 2)Data e kalimit të afatit për dhënien e informacionit e parashikuar në ligjin për të drejtën e Informimit

Komisioneri merr vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune nga dita e dorëzimit të saj.

Mosrespektimi i dispozitave të Ligjit për të drejtën e Informimit, sjell përgjegjësi administrative, sipas rasteve të parashikuara në nenin 18 të Ligjit.

### Çfarë vendos Komisioneri pas vlerësimit të ankesës suaj?

- a. Pranimin e kërkesës dhe urdhërimin e institucionit për të dhënë informacionin e kërkuar ose ndëshkon me gjobë kundër titullarit që ka penguar dhënien e informacionit.
- b. Mospranimin e kërkesës kur nuk është respektuar afati ose forma e paraqitjes
- c. Rrëzimin e ankesës, pjesërisht ose tërësisht.

Kërkuesi ose autoriteti publik ka të drejtë ta ankimojë vendimin e Komisionerit në gjykatën administrative kompetente.

Format Ankese

Në bazë të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”

<b>Emri / Mbiemri<sup>1</sup> :</b>
<b>Adresa:</b>
<b>Qyteti :</b>
<b>Telefon:</b>
<b>E-mail:</b>

<b>Autoriteti Publik :</b>
<b>Adresa:</b>
<b>Qyteti:</b>

*Identifikoni saktë Autoritetin Publik/Institucionin ndaj të cilit ankoheni.*

Përshkruani çdo veprim të pretenduar si shkelje nga Autoriteti Publik dhe nëse dispononi dokumente bashkëlidhini ato.

---

---

---

---

---

---

---

---

Përshkruani çfarë kërkon nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me nenin 24 të ligjit nr.119/2014.

---

---

---

(Data) \_\_\_\_\_

(Firma) \_\_\_\_\_

*Formulari i ankesës duhet të shoqërohet me formularin e kërkesës për informim drejtuar Autoritetit publik si dhe recetën postare ose emailin drejtuar Autoritetit Publik.*

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Për sqarime më të detajuara kontaktoni KDIMDP ose koordinatorin e të drejtës për informim.

<sup>1</sup> Në rastet kur informacioni i kërkuar përmban të dhëna personale, kërkohet dokumenti i identifikimit të kërkuarit.

## IV. Programi i Transparencës

## Programi i Transparencës

Informimi pa kërkesë realizohet nëpërmjet Programit të Transparencës (PT) i cili përkufizohet si tërësia e informacionit dhe mënyrat e bërjes publike të tij nga autoriteti publik. Bashkia, si njësi bazë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet Programit të Transparencës (PT) synon t'u garantojë qytetarëve të vet të drejtën e lirisë së shprehjes për çështjet vendore.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar një

Program model Transparence (PT) për qeverisjen vendore, i cili është i detyrueshëm për 61 bashkitë e vendit. PT përfaqëson instrumentin kryesor të transparencës në nivel vendor, që çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar ligjërisht ta zbatojë. PT synon ti bëjë bashkitë proaktive në lidhje me ofrimin e informacionit publik.<sup>1</sup>


Me anë të Programit të Transparencës, autoritetet vendore duhet të marrin në konsideratë interesin më të lartë të komunitetit, veçanërisht për të siguruar akses maksimal në informacionin në dispozicion të publikut, dhe të bëjnë publik sa më shumë informacion që të jetë e mundur, në mënyrë që të zvogëlohet nevoja për kërkesa individuale për informacion.

**PT përmban kategoritë e informacionit që duhet të bëhen publike pa kërkesë, të grupuara në 7 fusha si më poshtë:**

---

<sup>1</sup> Urdhër i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Nr.211, datë 10.09.2018  
“Për Miratimin e Programit Model të Transparence për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”.





## **Në këtë optikë tabela përmbledhëse e Programit është ndarë në 7 fusha kryesore:**

.....

Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë është fusha e parë e programit dhe përfshin kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë të përcaktuar nga neni 7 (pika: a; d; g; ç, dh) i ligjit 119/2014. Kjo fushë iu ofron qytetarëve informacion për ndarjen administrativo-territoriale, njësitë administrative përkatëse dhe nën-ndarjet e tyre, për misionin dhe funksionet e bashkisë, për organet e zgjedhura, për administratën e bashkisë, për statistikat vendore, për mekanizmat monitorues dhe të kontrollit si dhe për të drejtën e kërkesës, ankesave dhe vërejtjeve të qytetarëve që lidhen me veprimet ose mosveprimet e organeve dhe administratës së bashkisë.

Fusha e dytë, e titulluar Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare, është nga fushat më kryesore të Programit dhe përfshin kategoritë e informacionit të përcaktuar nga neni 7 (pika: dh; e; ë) i ligjit 119/2014. Këto kategori informacioni janë përshtatur me kërkesat e ligjit Nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”. Në këtë fushë përfshihen informacione që kanë të bëjnë me planin strategjik të zhvillimit të bashkisë, me programin buxhetor afatmesëm vendor, me paketën fiskale (taksa dhe tarifa), me buxhetin vjetor, me zbatimin, monitorimin, mbikëqyrjen dhe auditimin e buxhetit, me donacionet si dhe shitjen ose dhënien me qira të pronave dhe aseteve.

Për kërkesat për informim përbën fushën e tretë dhe përfshin vendosjen në dispozicion të qytetarëve të informacionit që ka të bëjë me procesin, procedurat, format dhe afatet e kërkesës për informim. Përmbledhja e katër kategorive të informacioni të përcaktuar në nenin 7 (pika c; ç; i; dhe k) të ligjit nr. 119/2014 në një fushë të vetme lehtëson aksesin e qytetarëve për këto kategori informacioni, i orienton dhe udhëzon ato se si mund të bëjnë një kërkesë për informim si dhe u krijon mundësi qytetarëve dhe grupeve të tjera të interesit të vlerësojnë dhe monitorojnë në tërësi këto katër kategori informacioni.

Një nga përgjegjësitë kryesore të bashkisë është ofrimi i shërbimeve publike duke përdorur instrumente të përshtatshme për të siguruar aksesin, cilësinë, sasinë dhe koston e përballueshme nga të gjithë grupet e komunitetit. Në këtë kontekst, fusha e katërt – Shërbimet Publike - është mbi shërbimet që ofron bashkia dhe përfshin kategoritë e informacionit të përcaktuar në nenin 7 (pika: f; j, ë dhe pjesërisht pika a) të ligjit 119/2014. Nëpërmjet kësaj fushe vihet në dispozicion të qytetarëve informacioni për shërbime publike që ofron bashkia, llojet e shërbimeve, instrumentet e administrimit, kontratat publike, strukturat përgjegjëse, procedurë e ankimimit në lidhje me kontratat publike, standardet, treguesit, procedurat për të përfituar shërbimet si dhe procedurat e ankesës dhe vërejtjes në lidhje me shërbimet.

Në hyrje të Kartës Evropiane për Autonominë Vendore përcaktohet se “e drejta e qytetarëve për të marrë pjesë në drejtimin e çështjeve publike bën pjesë në parimet demokratike të përbashkëta”. Kjo e drejtë e qytetarëve mundësohet nga ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” dhe në Program është

paraqitur si fushë më vete dhe përfaqëson fushën e gjashtë të saj, e cila vendos në dispozicion të qytetarëve informacion në lidhje me procesin, procedurat, kuadrin rregullator vendor, listën e akteve vendore që i nënshtrohen konsultimit publik dhe nismat qytetare.

Në fushën e shtatë bashkia vë në dispozicion të qytetarëve informacion të ndryshëm të tillë si: proceset e integritetit evropian (programet dhe projektet); shoqëria civile; raporte, studime dhe vlerësime të ndryshme, veçanërisht ato në lidhje me vlerësimin e transparencës etj; vet-organizimi komunitar.

## Strukturat për Informacion dhe Monitorim mbi të drejtën për informim



- **Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP)** është autoriteti përgjegjës, i pavarur, që mbikëqyr dhe monitoron, të drejtën për informim të individëve si dhe shqyrton ankimet administrative. KDIMDP është i pavarur.
- **Kryetari i bashkisë** vlerëson dhe mbikëqyr të gjithë procesin e zbatimit të programit të transparencës nga ana e administratës së bashkisë, njësive administrative dhe njësive të varësisë. Monitorimi i zbatimit të Programit të Transparencës do të bëhet jo më pak se njëherë në vit nga ana e këshillit dhe kryetarit të bashkisë nëpërmjet përdorimit të sistemit të matjes që shoqëron Programin model.
- **Koordinatorët e së drejtës për informim**, dhe rastet kur mbajnë përgjegjësi administrative. Në çdo autoritet publik, titullari cakton një prej nëpunësve si koordinator për të drejtën e informimit, detyra e të cilit është mbikëqyrja e përgjigjeve të autoriteteve ndaj kërkesave për informacion. Koordinatori nxit zbatimin e së drejtës për informim në nivel vendor.
- **Këshilli Bashkiak** mbikëqyr informimin e publikut nga ana e bashkisë duke analizuar dhe vlerësuar shkallën e zbatimit të rregullave që ai vetë ka vendosur për këtë qëllim.

- **Aktorët jo-publikë** që gjithashtu monitorojnë zbatimin e Programit të Transparencës përfshijnë organizatat e shoqërisë civile, median, biznesin, qytetarët dhe grupe të ndryshme.

## Transparenca proaktive, duhet të jetë në përputhje me parimet e mëposhtme:

**Të jetë i aksesueshëm për të gjithë qytetarët** informacioni që ka të bëjë me veprimtarinë e institucionit, duke filluar me buxhetin, informacione mbi prokurimet publike, kuadrin ligjor ose rregullator, kontratat e koncesioneve, CV-të e punonjësve dhe subjektet që deklarojnë pasuritë e tyre, organigramën etj.

**Ligjshmëria, transparenca dhe antidiskriminimi.** Aksesit në informacion duhet të sigurohet në përputhje me të gjithë kuadrin ligjor në fuqi, por duke i dhënë përparësi ligjit për të drejtën e informimit.

**Ofrimi i informacionit falas.** Tarifat e vendosura për vënien në dispozicion të informacionit publik konsiderohen si një pengesë për të aksesuar informacion publik. Për këtë arsye, transparenca proaktive mundëson që një pjesë e madhe e informacioni të bëhet publik në faqet e internetit, duke siguruar kështu akses falas për të gjithë qytetarët. Ndërsa në rastet kur informacioni i kërkuar është voluminoz, duhet të ofrohet kundrejt një tarife të përcaktuar.

**Akses për këdo.** Aksesit në informacion duhet t'u ofrohet të gjithëve, duke i dhënë gjithashtu një fokus të veçantë grupeve më të prekura të shoqërisë dhe shtresave në nevojë (të varfërve, të papunëve, personave të marginalizuar, personave me aftësi të kufizuara, si dhe minoriteteve).

Është shumë e rëndësishme që informacioni i vënë në dispozicion të qytetarëve të jetë:

**Monitorimi qytetar i transparencës dhe llogaridhënies në nivelin e vetëqeverisjes vendore ka nisur zbatimin**

Është shumë e rëndësishme që informacioni i vënë në dispozicion të qytetarëve të jetë:

- i plotë,
- i saktë;
- i përditësuar;
- i lehtë për t'u shqyrtuar;
- i kuptueshëm;
- lehtësisht i aksesueshëm;
- në përputhje me dokumentet origjinale të institucionit përkatës;
- lehtësisht i përdorshëm.

V.Instrumenti i Vlerësimit së Transparencës Proaktive

## Instrumenti i Vlerësimit së Transparencës Proaktive



**Analizon një grup treguesish të transparencës dhe llogaridhënies me qëllim për të matur dhe raportuar në mënyrë periodike nivelin e transparencës të secilës bashki. Një sistem i tillë i shërben të gjithë aktorëve:**

- Bashkitë, pasi mundëson evidentimin e pikave të dobta dhe të forta për secilën bashki;
- Komisionerit, sepse i vë në dispozicion një instrument të unifikuar monitorimi në përputhje me Programin Model të Transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- Aktorëve të tjerë si p.sh. të rinjve, OSHC-të apo mediave, të cilët duke monitoruar transparencën e institucioneve me anë të këtij instrumenti, ndikojnë në rritjen e llogaridhënies së bashkive.

## VLERËSIMI PROAKTIV

### Programi i Transparencës

Sipas Urdhërit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Nr.211, datë 10.09.2018 “Për Miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, brenda 10 ditëve nga data e miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak, Programi i Transparencës publikohet (i) në faqen zyrtare të internetit të bashkisë në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës” (linku)

*Instrumenti i Vlerësimit së Transparencës ka për qëllim të realizojë një vlerësimin objektiv të dokumentacionit që duhet të publikohet në Programin e Transparencës, sipas parashikimeve të nenit 7 të ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” të grupuar në 7 indikatorë në fushën e 3-te dhe te 7-të të PT-së.*

**Të rinjtë do të vlerësojnë përkatësisht 2 fusha të programit të transparencës, që përmbajnë 10 nënfusha në total, përkatësisht**  
**Fusha III Kërkesat për informim (23 indikatorë)**  
**Fusha VII Informacion tjetër (10 indikatorë)**  
**Totali maksimal i shumës së indikatorëve është 56 pikë**

Shënim: Për bashkitë të cilat kanë problem me aksesueshmërinë e informacionit në rubrikat e PT, do të vlerësohet informacioni i cili pasqyrohet ne website dhe media sociale me të njëjtën pikëzim, por duke ulur 50% të pikëve totale.

Monitorimi i transparencës përfshin edhe vlerësimin e transparancës online, ku vlerësohet transparenca e informacionit të paraqitur në website të bashkive, media sociale. Faqet e internetit, që përfaqësojnë infrastrukturën bazë që mundëson publikimin proaktiv.

## B. Vlerësimi i Transparencës reaktive përmes kërkesave për informim

Sipas nenit 11 të Ligjit 119/2014, qytetarët kanë të drejtë të informohen dhe përmes kërkesave për informim. Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij. Në çdo rast, kërkesa regjistrohet në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, të parashikuar në nenin 8 të këtij ligji. 2. Në çdo rast, kërkesa për informim regjistrohet dhe për të caktohet një numër rendor. Numri rendor, së bashku me të dhënat e kontaktit të koordinatorit për të drejtën e informimit, i jepen kërkuarit që ka bërë kërkesën për informim.

Monitorimi merr përsipër të vlerësojë transparencën në terren apo shkallën e gatishmërisë së bashkive për të dhënë informacion përmes kërkesave për informim (informimi aktiv). Për një qasje më gjithëpërfshirëse të vlerësimin të transparencës në tërësi, sugjerohet edhe vlerësimi i transparencës reaguese, pasi ajo ofron pamjen më të gjerë dhe të plotë të hapjes së institucionit ndaj publikut.

Më konkretisht, të rinjtë do të dërgojnë kërkesa për informim në bashkitë përkatëse, ku çdo kërkesë përmbante pyetje në lidhje me informacionin / indikatorët që përmbajnë 10 nënfushat e programit të transparencës. Pyetjet do të hartohen në bazë të fushës së interesit të të rinjve, dhe në total do të jenë rreth 10 pyetje nga fusha/ nënfusha të ndryshme.

## PIKËZIMI DHE TRANSPARENCA E BASHKIVE

Çdo indikator mund të vlerësohet me 0, 1 dhe 2 pikë, në bazë të sasisë dhe cilësisë së informacionit që rezulton në lidhje me të nga monitorimi. Monitoruesi shënon me X vlerësimin përkatës, duke marrë në konsideratë faktin se vlerat që mund të marrin indikatorët janë:

- 0 Informacioni nuk ekziston, apo ekziston thjesht si kategori informacioni në faqen e internetit të bashkisë, por nuk është i aksesueshëm;
- 1 Informacioni i publikuar është pjesërisht i plotë;
- 2 Kategoria e informacionit të publikuar është e plotë dhe e aksesueshme.

Bazuar në pikëzimin e çdo indikatorit llogaritet shuma totale e vlerësimit për secilën bashki. Ky pikëzim mund të shërbejë për të parë jo vetëm pikët totale të secilës bashki, por dhe për t'i krahasuar bashkitë me njëra-tjetrën. Gjatë monitorimit të nivelit të transparencës duhet të llogaritet dhe indeksi i transparencës, që është raporti midis rezultatit të pikëzimit që del nga

monitorimi me maksimalen e mundshme të pikëve për çdo bashki. Duke përdorur tabelën e shkallëzuar në kuantile të Sistemit të Matjes së Transparencës dhe Llogaridhënies, bëhet specifikimi relativ i shkallës së transparencës dhe llogaridhënies në njësinë përkatëse. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur një ndarje e niveleve të transparencës në 5 grupime të mëdha:

1. transparencë e ulët;
2. transparencë pjesërisht e ulët;
3. transparencë mesatare;
4. transparencë pjesërisht e lartë;
5. transparencë e lartë.





Fusha III Kërkesat për informim (23 indikatorë)					
Nënfusha	Indikatori	Vlerësimi			
		Informacioni nuk ekziston, apo ekziston thjesht si kategori informacioni në faqen e internetit të bashkisë, por nuk është i aksesueshëm; V = 0	Informacioni i publikuar është pjesërisht i plotë; V = 1	Kategoria e informacionit të publikuar është e plotë dhe e aksesueshme V = 2	Nr. i pikëve
1. Të dhënat e koordinatorit për informim (5 indikatorë)	a) Emër mbiemër i koordinatorit				
	b) Adresa postare/ elektronike e tij				
	c) Orari i punës				
	d) Detyrat dhe kompetencat e koordinatorit				
	e) Adresa postare/elektronike për depozitimin e kërkesave për informim				
<b>Totali nënfusha 1: Të dhënat e koordinatorit për informim</b>			<b>Max = 10 pikë</b>		
2. Standardet dhe procedurat që duhen ndjekur për të bërë kërkesë për informim dhe ankimim (6 indikatorë)	a) Procedura që duhet ndjekur për të bërë një kërkesë për informacion				
	b) Adresa postare/ elektronike për dërgimin e kërkesës për informim				
	c) Modeli standard i një kërkesë për informim				
	d) Afatet e marrjes së përgjigjes				
	e) Procedurat që duhen ndjekur për të bërë një ankim për mosdhënie informacioni				
	f) Adresa postare/ elektronike për dërgimin e ankimit për mosdhënie informacioni				
<b>Totali nënfusha 2: Standardet dhe procedurat që duhen ndjekur për të bërë kërkesë për informim dhe ankimim</b>			<b>Max = 12 pikë</b>		

**Fusha III Kërkesat për informim (23 indikatorë)**

Nënfusha	(23 indikatorë)	Vlerësimi			
		Informacioni nuk ekziston, apo ekziston thjesht si kategori informacioni në faqen e internetit të bashkisë, por nuk është i aksesueshëm; <b>V = 0</b>	Informacioni i publikuar është pjesërisht i plotë;  <b>V = 1</b>	Kategoria e informacionit të publikuar është e plotë dhe e aksesueshme  <b>V = 2</b>	<b>Nr. i pikëve</b>
<b>3. Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve (3 indikatorë)</b>	a) Të gjitha kërkesat për informim	<b>Nënfusha</b>			
	b) Informacioni i dhënë në përgjigje të tyre				
	c) Përditësimi çdo 3 muaj				
<b>Totali nënfusha 3: Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve</b>			<b>Max = 6 pikë</b>		
<b>4. Informacioni i dhënë më parë (1 indikator)</b>	a) Informacioni i disponueshëm në mënyrën më praktike të mundshme për të gjithë personat e tjerë që mund ta kërkojnë në të ardhmen				
<b>Totali nënfusha 4: Informacioni i dhënë më parë</b>			<b>Max = 2 pikë</b>		
<b>5. Trajtimi i kërkesave për informacion (3 indikatorë)</b>	a) Procedura e regjistrimit të kërkesës në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve				
	b) Afatet e trajtimit të kërkesës nga ana e administratës së bashkisë				
	c) Mënyra e dhënies së informacionit				
<b>Totali nënfusha 5: Trajtimi i kërkesave për informacion</b>			<b>Max = 6 pikë</b>		
<b>6. Kufizimi i së drejtës për informim (1 indikator)</b>	a) Rastet e kufizimit të së drejtës për informim sipas ligjit për të drejtën për informim				
<b>Totali nënfusha 6: Kufizimi i së drejtës për informim</b>			<b>Max=2 pikë</b>		

Fusha III Kërkesat për informim (23 indikatorë)					
Nënfusha	Indikator	Vlerësimi			
		Informacioni nuk ekziston, apo ekziston thjesht si kategori informacioni në faqen e internetit të bashkisë, por nuk është i aksesueshëm; <b>V = 0</b>	Informacioni i publikuar është pjesërisht i plotë; <b>V = 1</b>	Kategoria e informacionit të publikuar është e plotë dhe e aksesueshme <b>V = 2</b>	Nr. i pikëve
7. Tarifa për dhënien e informacionit nëse ka (3 indikatorë)	a) Të gjitha kërkesat për informim				
	b) Informacioni i dhënë në përgjigje të tyre				
	c) Përditësimi çdo 3 muaj				
<b>Totali nënfusha 7: Tarifa për dhënien e informacionit nëse ka</b>			<b>Max = 6 pikë</b>		
8. Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh (1 indikator)	a) Informacione dhe dokumente të kërkuara më shpesh nga publiku me kërkesë për informim				
<b>Totali nënfusha 8: Informacion dhe dokumente që kërkohen shpesh</b>			<b>Max = 2 pikë</b>		
<b>Totali Fusha III:</b>				<b>Max = 46 pikë</b>	

**Fusha VII Informacion tjetër (10 indikatorë)**

Nënfusha	Indikat ori	Vlerësi mi			
		Informacioni nuk ekziston, apo ekziston thjesht si kategori informacioni në faqen e internetit të bashkisë, por nuk është i aksesueshëm; <b>V = 0</b>	Informacioni i publikuar është pjesërisht i plotë; <b>V = 1</b>	Kategoria e informacionit të publikuar është e plotë dhe e aksesueshme <b>V = 2</b>	Nr. i pikëve
<b>TRANSPARENCA PROAKTIVE</b>					
1. Bashkia në proceset e integritit evropian (1 indikator)	1. Të dhëna mbi projektet, nismat dhe veprimtarisë e bashkisë në kuadrin e integritit nëBE				
2. Bashkia dhe shoqëria civile (4 indikatorë)	2. Në tërësi të dhëna për grupet e interesit				
	3. Të dhëna për OJF-të, përfaqësuesit e medias, biznesit				
	4. Shërbimet që ofrohen nga organizata të ndryshme				
	5. Nismat advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile				
<b>Totali: Max = 10 pikë</b>					

**TOTALI: FUSHA III ( 46) + FUSHA VII ( 10)= 56 pike**

A1/ TRANSPARENCA PROAKTIVE- WEBSITE DHE MEDIA SOCIALE ( nëse informacioni ne Programin e Transparencës nuk eshte i aksesueshem)

Fusha III Kërkesat për informim (23 indikatorë)				
Nënfusha	Indikatori	Vlerësimi		
		Informacioni nuk ekziston, apo ekziston thjesht si kategori informacioni në faqen e internetit të bashkisë, por nuk është i aksesueshëm; <b>V = 0</b>	Informacioni i publikuar është pjesërisht i plotë; <b>V = 1</b>	Kategoria e informacionit të publikuar është e plotë dhe e aksesueshme <b>V = 2</b>
Totali nënfusha 1: Të dhënat e koordinatorit për informim				
Totali nënfusha 2: Standardet dhe procedurat që duhen ndjekur për të bërë kërkesë për informim dhe ankimim				
Totali nënfusha 3: Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve				
Totali nënfusha 4: Informacion i dhënë më parë				
Totali nënfusha 5: Trajtimi i kërkesave për informacion				
Totali nënfusha 7: Tarifa për dhënien e informacionit nëse ka				
Totali nënfusha 8. Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh				
Totali				23 pike

I: FUSHA III ( 46) + FUSHA VII ( 10)= 56 pike

Tabela e pikëzimit

<b>Nr.i pikëve totale</b>	<b>Përqindja</b>	<b>Niveli i transparencës</b>
0-19	0-35%	transparencë e ulët;
20-29	36-53%	transparencë pjesërisht e ulët;
30-39	54-70%	transparencë mesatare;
40-49	71-88%	transparencë pjesërisht e lartë;
50-56	89-100%	transparencë e lartë.

## Aneks2. Ushtrime praktike

### **Ushtrim 1. Si të formulojmë një kërkesë dhe ankesë në lidhje me të drejtën e informimit.**

Të gjithë pjesëmarrësve u jepet një format tip kërkesë dhe ftohen ta plotësojnë. Fillimisht pjesëmarrësit instruktohen se si mund të bëjnë një kërkesë për një informacion që mund të jetë i rëndësishëm për ta. Plotësojnë kërkesën dhe më pas trajnuesi apo vetë pjesëmarrësit lexojnë kërkesat. Diskutohet në grup nëse kërkesa ka qenë konform standardeve të kërkuara dhe ka plotësuar të gjitha kushtet.

Në pjesën e dytë të ushtrimit, pjesëmarrësve u jepet një format tip ankese. Pjesëmarrësit ftohen të bëjnë një ankesë ndaj një institucioni publik, duke shpjeguar edhe arsyet. Më pas ankesa lexohet dhe diskutohet në grup nëse qytetari ka plotësuar të gjitha detyrimet ligjore.

### **Ushtrim 2. Si informojnë bashkitë?**

Pjesëmarrësit ndahen në grupe me nga 4-5 individë në secilin grup. Secili grup ftohet të përzgjedhi në mënyrë rastësore 5 bashki. Pjesëmarrësit duhet të identifikojnë format e informimit të bashkisë dhe ti diskutojnë më njëri tjetrin, duke reflektuar mbi disa pyetje:

- A mendoni që mjetet e informimit janë të mjaftueshme për të plotësuar nevojat e të gjitha grupeve në komunitet?
- A mendoni që informacioni i ofruar publikisht është konform standardeve ligjore?
- A është publikuar informacioni në Programin e Transparencës?
- A janë bërë publike të dhënat e Koordinatorit për të drejtën e informimit?
- A është publik regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve?
- A janë plotësuar me informacion të plotë rubrikat në Programin e Transparencës?

### **Ushtrim 3. Luajtje Roli**

Në webfaqen e komisionerit gjeni vendimet dhe rekomandimet që ka ndërmarrë komisioneri përgjatë viteve në lidhje me moszbatimin e të drejtës së informimit për institucionet publike. Përzgjidhni një vendim që mendoni se është relevant në lidhje me të drejtën e informimit në nivel vendor. Pjesëmarrësit ndahen në grupe të vogla me rreth 4- anëtare. Secili grup përzgjedh në bazë të vendimit të Komisionit 3 aktorë: Komisionerin, Institucionin publik dhe Ankuesin.

Pyetje:

1. A është informacioni i kërkuar informacion publik?
2. A duhet refuzuar dhënia e këtij informacioni?
3. Çfarë duhet të bëjë organizata “x” pas refuzimit dhënies së informacionit?

### **Ushtrim 4. Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve**



Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre.

Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik si dhe në mjediset e pritjes së publikut e në mjediset e autoritetit publik.

Pyetje :Analizoni tipologjinë dhe natyrën e kërkesave për informacion të një bashkie.

**Ushtrim 4 . Vlerësoni transparencën proaktive në fushën 3 dhe 7 të Programit të Transparencës sipas Instrumentit të Vlerësimit së Transparencës Proaktive**

